

VENDIM

Nr. 271, datë 25.5.2023

PËR FILLIMIN E FUNKSIONIMIT TË GJYKATËS ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË TIRANË TË RIORGANIZUAR

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 135, pika 1, 147, pika 1, 147/a, shkronja “ë” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 13 dhe 66 të ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 44 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe nenin 61, paragrafi 2, shkronja “ë” të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

V E N D O S I :

SEKSIONI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Emërtimi dhe selia

1. Gjykata e Administrative e Shkallës së Parë Tiranë mban të njëjtin emërtim pas datës 1.7.2023.
2. Selia e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është në Tiranë, në adresën: Rruga "Ibrahim Pashë Bushatliu", nr.1001, Tiranë.
3. Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë Durrës, Korçë dhe Shkodër ndërpresin veprimtarinë më datë 30.6.2023.

SEKSIONI II ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I GJYKATËS ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË TIRANË

Neni 2

Gjyqtarët e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

1. Numri i gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë përcaktohet me akt të veçantë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Gjyqtari i emëruar/caktuar në një pozicion të përhershëm në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë qëndron në të njëjtin pozicion në strukturën e re të kësaj gjykate.
3. Gjyqtari i emëruar/caktuar në një pozicion të përhershëm në gjykatat administrative të shkallës së parë Durrës, Korçë dhe Shkodër, të cilit i suprimohet pozicioni për shkak të riorganizimit gjyqësor, transferohet në pozicion të përhershëm në strukturën e re të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
4. Pozicionet e shpallura për lëvizje paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për të cilat në datën 1.7.2023 nuk ka përfunduar ende procedura e lëvizjes paralele, konsiderohen pozicione të lira të përhershme në strukturën e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë të riorganizuar. Këshilli i Lartë Gjyqësor pas datës 1.7.2023 vijon

procedurat e papërfunduara për llogari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë të riorganizuar.

SEKSIONI III ORGANET E ADMINISTRIMIT GJYQËSOR

Neni 3

Organet e administrimit gjyqësor

1. Kryetari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë zgjidhet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor sipas përcaktimit të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

2. Në mungesë të kryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, kompetencat ushtrohen nga zëvendëskryetari i gjykatës deri në zgjedhjen e kryetarit.

3. Zëvendëskryetari në detyrë i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë qëndron në detyrë deri në përfundim të mandatit, me përjashtim të rasteve kur ka shkaqe për mbarimin e statusit të magjistratit.

4. Kancelari në detyrë i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë qëndron në detyrë deri në emërimin e kancelarit të ri të kësaj gjykate, sipas ligjit.

5. Këshilli i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, deri në zgjedhjen e kryetarit dhe emërimin e kancelarit, përbëhet nga zëvendëskryetari, kancelari në detyrë dhe gjyqtari me përvojën profesionale më të gjatë si gjyqtar në datën e fillimit të funksionimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë të riorganizuar.

SEKSIONI IV ADMINISTRIMI I BRENDSHËM GJYQËSOR

Neni 4

Administrata gjyqësore

1. Administrata gjyqësore e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e përbërë nga punonjësit që ushtrojnë shërbimet gjyqësore, administrative dhe mbështetëse sipas përcaktimit të ligjit, vijon të ushtrojë veprimtarinë dhe nuk i nënshtrohet procesit të ristrukturimit.

2. Administrata gjyqësore e gjykatave administrative të shkallës së parë Durrës, Korçë dhe Shkodër i nënshtrohet procesit të ristrukturimit.

3. Këshilli i Lartë Gjyqësor përcakton me akt të veçantë krijimin dhe funksionimin e Komisionit të Ristrukturimit, sipas ligjit.

4. Rregullat standarde për strukturën dhe organika e administratës gjyqësore të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë të riorganizuar, përcaktohen me akt të veçantë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

SEKSIONI V TRANSFERIMI DHE MENAXHIMI I ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Neni 5

Transferimi i çështjeve gjyqësore

1. Çështjet gjyqësore të regjistruara në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë,

Durrës, Korçë dhe Shkodër deri në datën 30.6.2023, por që nuk kanë përfunduar sipas ligjit, transferohen në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të riorganizuar.

2. Çështjet gjyqësore që transferohen në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, regjistrohen në regjistrat manualë dhe sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve ICMIS.

3. Për zbatimin e pikës 1 dhe 2 të këtij neni ngarkohet Departamenti i Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Neni 6

Menaxhimi i çështjeve gjyqësore

Çështjet gjyqësore të transferuara në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë nuk i nënshtrohen rindarjes me short. Këto çështje vijojnë të shqyrtohen nga i njëjti trup gjykues.

SEKSIONI VI PËRGJEGJËSITË BUXHETORE DHE FINANCIARE

Neni 7

Përgjegjësitë buxhetore dhe financiare

Gjykata Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, mbështetur në legjislacionin në fuqi, përmbush të gjitha detyrimet dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga mbyllja në datë 30.6.2023 e aktivitetit ekonomiko-financiar të gjykatave administrative të shkallës së parë Durrës, Korçë dhe Shkodër.

Neni 8

Hyrja në fuqi e vendimit

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETARE
Naureda Llagami